



REPUBLIKA E KOSOVËS

/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË / OSNOVNI SUD U MITROVICI / BASIC COURT IN MITROVICA

C.nr. 184/2012

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshitjen juridike te paditesit; nga te cilein e perfaqson Avokat; nga sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditureve; ve; nga tani me vendbanim te panjohur te ciliet i perfaqson Prefaqsuasi i perkohshem, Avokat nga, sipas aktvendimit te kesaje gjykate, baza e kontestit; Vertetim pronesie, vlera e kontestit; 800,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.05.02.2013, jep kete;

AKTGJYKIM

I- APROVOHET kerkespadia e paditesit dhe VERTETOHET se-Paditesi nga eshte shfrytzues i perhershem i pjeses se parc.kat. me kultur, arc e klasesi II- ne vendin e qujtur, ne siperfaqe S=394 m2, si dhe shfrytzues i pjeses se rruges me siperfaqe prej S=276m2 me masat dhe kufinjte e truallit dhe rruges qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes. sipas qertifikates se pronesis nr. Zk- e qe evidentohet ne emer te paditureve; 3/210, 6/210, 6/210, 3/210, 6/210, vej. 60/210, [] 60/210, [] 60/210,, dhe [] 6/210.

II- DETYROHEN te paditurit qe ti njohin kete te drejte paditesit dhe te lejojne qe paditesi kete palujtshmeri ta regjistrojne ne emer te tije prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne, ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

-Secila palei barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.



Arsyetim

Paditesi ne padin e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tije ne seancat e mbajtura ka theksuar se ne vit. 1980 e ka bler palujtshmerin e cekur ne dispozitiv nga te paditurit dhe qe nga momenti i shitblerjes paditesi sbashku me familje te tije ka hyre ne posedim te prones, ku te njejtën ne vazhdimesi e kane shfrytzuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese. Paditesi tani vone ka kuptuar qe palujtshmeria e cila eshte ne posedim faktik te tije qe nga blerja e saje nuk evidentohet ne emrin e tije, andaj kane interes juridik qe kjo palujtshmeri edhe juridikisht te evidentohet ne emerit e tije.

Pasi qe te paditurit jane ne adrese te panjohr i propozoje gjykates qe te iu caktoi perfaqsesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padin dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar nga se paditesi kete palujtshmeri e ka fituar ne baze te mbajtjes dhe shitblerjes.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nen 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK, gjykata me aktvendimin C. nr. dt 14.04.2011 te paditureve iu caktoi Perfaqsesin e perkohshem, Avokat i cili ne baze te ketije aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nen. 82.1.2 te LPK.


Perfaqsesi i perkohshem i te paditureve ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit i propozoi gjykates qe te vendos ne baze te provave te administruara.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlensimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Certifikaten mbi pronesin, Ul te dt. 14.01.2013 ne emer te paditureve, lexoi ekspertzen gjeodete te ekspertit gjeodet; te dt. 14.12.2012, beri veshtrimin ne Skicen e terenit, Procesverbalin mbi vendshiqim te kesaje gjykate dt. 14.12.2012, ndegjoi deshmitaret; dhe si dhe ndegjoi paditesin ne cilsu te pales konstatoi kete gjendje faktike;

Nga Certifikata mbi te drejtat e prones se palujtshme te cekur me larte konstatohet se parc. kat. evidentohen ne emer te paditureve.



Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; pase matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te palujtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne , kane vertetuar se palujtshmerine kontestuese e perben parcelen e cekur me larte me masa dhe kufij te shenura si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe skicen e terenit e cila eshte pjese perberse e ekspertizes dhe te aprovur si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

Nga proqesverbali mbi vendshiqim. I2 kesaj gjykate i sipercekur konstatohet se ne ket palujtshmeri paditesi ka te ndertuara 2- shtepi te banueshme , njera perdhese e tjetra 1- katshe.

Deshmitari deklaroi ne at vend jeton nga viti 1971 dhe e din qe nga nje Serb ka bler diku 6 ari truall. Qmimi nuk i kujtohet por ka qen ne Dinar dhe ka qene prezent kur eshte ber shitblerja. N etrsi e ka paguar qmimin e shitberjes dhe meniher ka hy ne shfrytzim te ketij trualli ne te cilen e ka ndertu edhe shtepin per banim, ku tani ka 2 shtepi njera 1- katshe e tjetra 2- katshe.

Deshmitari deklaroi se me paditesin eshte fqinje dhe prejse e mban mend ne at vend ka jetuar ku te njejtin e ka bler nga 1- Serb me qfar qmimi nuk e din, ka diku 6 ari dhe se i njejt ka jetuar me familje pa kurfar pengese nga askush. Ne at vend ka 2- shtepi te ndertuara.

Paditesi en cilsu te pales deklaroi; ne vit 1980 babai im dhe une kemi bler nga nje Serb diku afer 6- ari are e qmimi sme kujtohet por ka qen ne Dinar. Shitblerja eshte ber sipas marrveshjes gojore dhe ne tersi e kan paguar qmimin e shitblerjes dhe menjeher kemi hy ne posedim dhe shfrytzim te kesaje are. Pase 1- vit kemi ndrtu shtepin per banim dhe nga ather gjermetani e shfrytzojn pa kurfar pengese nga askush. Tani ne ketvend ka te ndertura 2- shtepi , njera 1- katshe e tjetra 2.

Ne nje gjendje te ketill faktike te cekur me larte, gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se palujtshmerin tani lendore e ka bler i ati i paditesit si dhe paditesi ne vit. 1980, sipas marrveshjes gojore, me qmim te kontraktuar ne Dinar te cilin qmim ne tersi ia ka paguar shitesit i cili menjeher i ka lene ne shfrytzim te lire kete palujtshmeri, tani paditesit i cili sbashku me antaret e familjes e ka shfrytzuar ke t palujtshmeri pa pengesa nga askush nga shitblerja e gjermetani. Ne keta palujtshmeri paditesi ka te ndertuara 2- shtepi njena perdhese e tjetra 1- katshe.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronetin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronetin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes , paditesi e ka pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire keto palujtshmeri dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i kesaje palujtshmerie



Mbajtja me mirbesim ekziston se paditesi kete palujtsheri e ka blere nga pronari i saje qka vertetohet nga fleta poseduse ne emer te paditureve.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesi e ka blere kete palujtshmeri nga i paditeuri , qysh nga vitet 1980.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie lendore, gjer me tani. Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit ne menyre- derivative- me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450 dhe 459 te LPK.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C nr 184/2012 dt. 05.02.20123.



Gjyqtari,
Ragip Kadriu

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi mund te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine e permes kesaje gjykate.

Saktsin e pershkrimt e verteton;

*T. q. i. j. p. d. n.
per juri dhe shytan
= 30 t.*

*Te eoz.
1-akt juri.
1-akt juri
22.02.2013*

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD,
MITROVICE - MITROVICA

Mb. Dana. 01.03.2013

